



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:063681

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05831180

KPPP.nr. 591/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, dhe me seli në Prishtinë, rr. "Armend Daci", nr. 1, kundër debitorit "Albi Trans" Sh.p.k., me numër të biznesit 70430521 dhe me seli në fshatin Leshan, Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shqiponjë Beqiraj, avokat nga Peja, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 231/20, i lejuar me datë 07.10.2020, nga Përbaruesi Privat Shpend Ahmetaj, jashtë seancës, me datë 18.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit "Albi Trans" Sh.p.k., me numër të biznesit 70430521 dhe seli në Pejë, i ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 231/20, i lejuar me datë 07.10.2020, nga Përbaruesi Privat Shpend Ahmetaj.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 231/20, i lejuar me datë 07.10.2020, nga Përbaruesi Privat Shpend Ahmetaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, mbi bazën e dokumentit përbarues Aktvendimit me numër 3591, të datës 15.10.2018, ka lejuar urdhrin përbarimor P.nr.231/20, të datës 07.10.2020, me të cilin është urdhëruar debitori "Albi Trans" Sh.P.K., që, në emër të gjobës administrative, t'ia paguaj borxhin kreditorit në shumën prej EUR 7,456.25, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër urdhrin për lejimin e përbarimit debitori ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për përbarim, me arsyetim se aktvendimi nuk përmbushë kriteret e dokumentit të besueshëm, i njëjti është pa tipare të dokumenti përbarues në kuptim të nenit 71.1, pika 1.1 të LPP-së, dhe si i tillë nuk paraqet titull ekzekutiv për lejimin e përbarimit. Ka shtuar se, aktvendimi

përmban shkelej ligjore, për arsye se debitori disa herë ka bërë kërkesë për dhënien e pëlqimit, mirëpo ka marrë përgjigje negative e shpesh herë nuk ka marrë përgjigje fare. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk përmban shkaqe për të cilat urdhri mund të anulohet, në kuptim të nenit 71 të LPP-së. Ka shtuar se pretendimet e paraqitura në prapësim janë të pabazuara ngase nuk i referohet asnjë dispozite ligjore. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Fillimisht, kjo gjykatë me Aktvendimin KPPP.nr. 1408/22, të datës 29.05.2023 e ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit të paraqitur ndaj Urdhri Përmbartimor P.nr. 231/20, të lejuar me datë 07.10.2020, nga Përmbartuesi Privat Shpend Ahmetaj.

Ndaj këtij aktvendimi debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur ankesë, ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 1030/23, të datës 22.03.2024 e ka aprovuar ankesën e debitorit si të themeltë, ndërsa aktvendimin e Dhomave të Shkallës së Partë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1408/22, të datës 29.05.2023 e ka anuluar dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje pranë të njëjtës gjykatë.

Në rivendosje, gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke marr për bazë edhe udhëzimet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë në Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 1030/23, të datës 22.03.2024, bazuar në dispozitat e nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht Aktvendimi mbi bazën e së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, përcaktohen si dokument përmbartuese sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se Aktvendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin

1, pasi që është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi NR. 3591, i datës 15.10.2018, mbi bazën e së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, është i plotfuqishëm dhe mbanë vulën e ekzekutueshmërisë së datës 06.12.2018 dhe rrjedhimisht i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*.

Gjykata mori parasysh pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se aktvendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmban shkelje ligjore pasi që debitori ka bërë disa herë kërkesë për dhënien e pëlqimit ndërsa ka pranuar përgjigje negative nga ana e kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat pretendime nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë procedurë pasi që procedura përmbarimore i nënshtrohet paritmit të rigorozitetit formal mbi bazën e të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat të LPP-së.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 591/24, datë 18.06.2024

Gjyqtari

Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.